

## 5.3 FORMATI STANDARD

Formati standard i shfaqjes mundëson kontrollin e regjistrimit në formatin ISBD. Elementet e shfaqjes në skedën **Formati standard** janë të shënuara në këtë renditje:

- emërtimi
- përshkrimi bibliografik i njësisë
- përshkrimet shitesë (autorët, emërtimet lëndore)
- numri i sistemit të klasifikimit
- numri i identifikimit (COBISS.XX-ID)

Nëse me regjistrimet e përzgjedhura janë të lidhura edhe regjistrimet apo objektet e tjera, ato shfaqen në pjesën e dritares **Objektet e lidhura**.